



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**MINISTRI**

Nr. 3463 Prot.

Tiranë, më 5.7.2013

**URDHËR**

Nr. 285 datë 05.07.2013

**PËR**

**STRUKTURËN E VITIT SHKOLLOR 2013-2014**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

Struktura e vitit shkollor **2013-2014** të jetë si më poshtë:

**A. NË ARSIMIN BAZË:**

Mësim

Semestri i parë fillon më 16 shtator 2013 dhe mbaron më 5 shkurt 2014;  
Semestri i dytë fillon më 10 shkurt 2014 dhe mbaron më 18 qershor 2014.

Pushime:

Periudha e parë: 24 dhjetor 2013 deri më 7 janar 2014.

Periudha e dytë: 6 shkurt 2014 deri më 8 shkurt 2014.

Periudha e tretë: 19 mars 2014 deri më 23 mars 2014.

**Provimet e lirim** zhvillohen në periudhën 19-30 qershor 2014.

**B. NË ARSIMIN E MESËM:**

Mësim

Viti shkollor fillon më 16 shtator 2013 dhe mbaron më 20 qershor 2014.

Për maturat viti shkollor fillon më 16 shtator 2013 dhe mbaron më 30 maj 2014.

Pushime:


Periudha e parë: 24 dhjetor 2013 deri më 7 janar 2014.

Periudha e dytë: 19 mars 2014 deri më 23 mars 2014.

**Provimet e Maturës Shtetërore** zhvillohen në periudhën 31 maj-30 qershor 2014.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

MINISTRI

  
MYQEREM TAFAJ

